



**Kolegji AAB**  
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

**FAKULTETI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Programi: **Administratë Publike dhe Diplomaci**

**Studimet Master**

**Punim Masteri**

**Tema: Rruga Diplomatike e Kosovës për Pavarësi pas vitit 1999**

**Kandidati:**

Arben Krasniqi

**Mentori:**

Prof. Ass. Dr Donik Sallova

Prishtinë, 2024

## **Deklaratë e Autorësisë**

Me përgjegjësinë time më të lartë deklaroj se ky punim me titull: "Rruga diplomatike e Kosovës për pavarësi pas vitit 1999" është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë, i tëri apo pjesërisht. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveq rasteve të civateve dhe referencave të tjera (për të cilat është ruajtur burimi/ referencat/ fusnotat).

## **Falenderime dhe Mirënjohje**

Një rrugëtim si ky, në asnjë mënyrë, nuk do të mund të bëhej vetëm. Rrugëtim i cili shënon një tjetër arritje për mua, përfundimin e studimeve në nivelin master. Falenderime shumë të sinqerta dëshiroj të përcjell për të gjithë ata persona që më ndihmuan në realizimin e këtij punimi. Konkretisht falenderojë mentoren time Prof. Dr. Donik Sallova për mbështetjen, angazhimin dhe ndihmën e palodhur që më ka dhënë në arritjen e objektivave të punimit. Falenderoj gjithashtu të gjithë kolegët dhe miqtë e mi që më kanë ndihmuar me sugjerimet e tyre në përmirsimin e temës. I falenderoj nga zemra dhe shpreh mirënjohje të thellë familjes time që më ka përkrahur jashtëzakonisht shumë dhe kanë qenë një shtysë e madhe drejt realizimit të aspiratave të mia. Një falenderim i veçantë shkon edhe për të gjithë respondentët të cilët e kanë plotësuar pyetsorin në lidhje me temën përkatëse, kontributi i gjithësecilit prej tyre ka pasur një rëndësi mjaftë të madhe për realizimin e objektivave të studimit.

Ju faleminderit të gjithëve!

Arben Krasniqi

## **Fjalori i Termave**

**NATO** -Organizata e Aleancës Veri-Atlantike

**BE** – Bashkimi Evropian

**UNMIK** - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

**OKB** - Organizata e Kombeve të Bashkuara

**RSFJ** - Republika Federale e Jugosllavisë

**OSBE** - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**KFOR** – Forcat ndërkombëtare në Kosovë SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

## **Abstrakt**

Kjo temë e magjistraturës shqyrton rrugëtimin diplomatik të Kosovës pas vitit 1999 drejt pavarësisë. Tema e Kosovës dhe fillimi i diplomacisë ndërkombëtare ndaj Kosovës në rrugën e saj drejt pavarësisë dhe çlirimit nga Serbia janë temat kryesore të këtij punimi. Ky punim do të analizojë trajektoren historike dhe sekuencën kronologjike të ngjarjeve në Kosovë, me fokus në zgjedhjen e Kosovës për pavarësi dhe faktorët ndërkombëtarë që kanë kontribuar ndjeshëm në statusin e saj aktual si shtet i pavarur dhe sovran.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e njohu statusin ndërkombëtar të Kosovës më 22 korrik 2010, duke konfirmuar aktgjykimin këshillimor se pavarësia e vendit nuk ka shkelur asnjë nen të së drejtës ndërkombëtare.

Për popullin shqiptar, shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, shënoi kulmin e një rrugëtimi rraskapitës të mbushur me gjak dhe pikëllim. Ngjarjet më domethënëse në historinë e Kosovës deri më sot mendohet se kanë qenë shpallja e Shqipërisë në Kosovë dhe pranimi i saj si e dhënë në Prishtinë.

**Fjalët kyçe:** kosova, pavarësi, çlirim, diplomaci, faktorët ndërkombëtar

## **Abstract**

This master's thesis examines Kosovo's post-1999 diplomatic journey towards independence. The subject of Kosovo and the beginning of international diplomacy towards Kosovo on its road to independence and liberation from Serbia are the main topics of this topic. This paper will analyze the historical trajectory and chronological sequence of events in Kosovo, with a focus on Kosovo's choice for independence and the international factors that have contributed significantly to its current status as an independent and sovereign state.

The International Court of Justice acknowledged Kosovo's international status on July 22, 2010, confirming the advisory judgment that the country's independence has not broken any articles of international law.

For the Albanian people, the declaration of Kosovo independence on February 17, 2008, marked the culmination of a grueling journey filled with blood and sorrow. The most significant events in Kosovo's history to date are thought to have been the proclamation of Albania in Kosovo and its acceptance as a given in Pristina.

**Key words:** kosovo, independence, liberation, diplomacy, international factors

## **Tabela e përmbajtjes**

<b>Deklaratë e Autorësisë</b> .....	
<b>Falenderime dhe Mirënjohje</b> .....	
<b>Fjalori i Termave</b> .....	
<b>Abstrakt</b> .....	
<b>Abstract</b> .....	
<b>Hyrje</b> .....	
<b>Kapitulli I</b> .....	
1.1 Qëllimi i këtij punimi të masterit .....	
1.2 Organizimi i temës .....	
1.3 Rëndësia e temës .....	
1.4 Rishikimi i literaturës .....	
<b>Kapitulli II</b> .....	
<b>2.Roli i diplomacisë ndërkombëtare dhe kosovare në rrugën e Kosovës drejt pavarësisë .....</b>	
2.1 Roli i diplomacisë ndërkombëtare në rrugën e Kosovës drejt Pavarësisë.....	
2.1.1 Statusi final si zgjidhje e vetme e qëndrueshme.....	
2.2 Roli i diplomacisë kosovare në rrugën e Kosovës drejt Pavarësisë .....	
2.2.1 Pavarësia (2008-2019).....	
2.2.2 Njohja e Republikës së Kosovës .....	
2.2.3 Njohja dhe mos - njohja e Pavarësisë së Kosovës në nivel ndërkombëtarë .....	
2.2.4 Reformat në qeverisjen e shtetit më të ri në botë - decentralizimi .....	

**KAPITULLI III .....**

3.1 Metodologjia e hulumtimit.....

**KAPITULLI IV.....**

4.1 Prezantimi i rezultateve.....

4.1.1 Hipotezat e hulumtimit .....

4.2 Përfundime dhe rekomandime .....

## **Kapitulli I – Hyrje**

**Natyra e temës:** Kjo temë është shumë atraktive dhe me shumë interes të hulumtohet sepse paraqet përpjekjet shekullore të Kosovës për liri dhe pavarësi nga Serbia. Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe njohja e saj ndërkombëtare, në Prishtinë konsiderohen si datat më të rëndësishme të historisë së deritashme të Kosovës. Përpjekjet e kosovarëve dhe popullatës shumicë për liri datojnë për një shekull, përderisa përpjekjet për krijimin e një shteti të pavarur datojnë për një kohë të gjatë, por ato kanë marrë forma më konkrete të organizimit nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta. Atëherë, kur edhe filloi shpërbërja e ish-Jugosllavisë (Gashi, 2008). Punimi ka në fokus çështjen e Kosovës dhe çasjen e diplomacisë ndërkombëtare ndaj kësaj problematike me qëllim të pasqyrit, analizimit dhe të shpjegimit të qëndrimit fillestar unik ndërkombëtar i cili në të gjitha variantet e zgjidhjes së statusit të Kosovës, atë e konsideronin si pjesë të pandashme të Serbisë, e asesi të pavarur deri tek evoluimi i këtij qëndrimi në mbështetjen dhe ndihmën ndërkombëtare për arritjen e një pavarësie të mbikqyruar ndërkombëtare për Kosovën.

**Motivi i temës::** Duke parë armiqësinë shekullore mes të dyja vendeve për mua si studiues motivimi kryesor për ta trajtuar këtë temë ka qenë pikërisht kjo se cilat rrugë dhe cilat hapa të ndërrmarra nga Kosova përgjatë gjithë periudhave dhe përpjekjeve për pavarësi kanë determinuar përpjekjet e vendit tonë për pavarësimin dhe shkëputje nga Serbia gjë e cila zyrtarisht ndodhi e u bë realitet me 17 shkurt 2008. Kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet sepse duke e shtjelluar këtë temë do të nxirren konkludime mbi bazën e asaj se sa e rëndësishme ka qenë kauza e popullit kosovarë për pavarësi, mbi këtë fakt bazohet edhe ndihma që Kosova e mori nga aleatët ndërkombëtarë për Çlirim dhe shkëputje nga Serbia.

**Qëllimi shkencor i punimit:** Qëllimi është të shpjegohet nga këndvështrimi historiko-politik procesi i pavarësimit të Kosovës si dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në këtë drejtim. Të ofrojë një analizë të hollësishme të qëndrimeve unike ndërkombëtare që fillimisht ishin pro egzistencës dhe vazhdimit të Ish-Jugosllavisë dhe kundër pavarësimit të Kosovës e deri tek ndryshimi i ketyre qëndrimeve. Studimi në thelb nuk shtjellohet nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare por nga aspekti politik dhe historik I saj, meqenëse faktori ndërkombëtar që nga fillimi çështjen e Kosovës nuk e ka trajtuar si problem i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nga këndvështrimi

humanitar.

### **1.1 Qëllimi i këtij punimi të masterit**

Ky punim ka për qëllim të pasqyroj rrugën diplomatike të cilën e ka ndjekur Kosova për pavarësi pas vitit 1999. Duke e ditur kronologjinë e ngjarjeve të cilat e kanë karakterizuar Kosovën gjatë viteve 90-99 si dhe periudhën e luftës me Serbinë, nëpërmjet këtij punimi synohet të bëhet një përmbledhje e të gjitha ngjarjeve të cilat e kanë përcjellur Kosovës nga periudha më delikate e luftës deri tek kurorëzimi me pavarësi me 17 shkurt 2008. Gjithashtu qëllim i këtij punimi është të evidentoj, të analizojë dhe të interpretojë faktorët që kanë penguar ose ndihmuar aspiratën e Kosovës për pavarësi.

### **Objektivat**

Në kuadër të hulumtimit do të trajtohen këto objektiva si më poshtë:

- Të evidentojmë fazat apo etapat nëpër të cilat ka kaluar rruga e Kosovës për pavarësi pas vitit 1999.
- Të shqyrtojmë faktorët e mbrendshëm dhe të jashtëm që kanë ndikuar përpjekjet diplomatike të Kosovës për pavarësi.
- Të analizojmë veprimet në fushën e diplomacisë që politika dhe institucionet e Kosovës kanë ndjekur për ta fituar pavarësinë.
- Të interpretojmë ndikimin që faktorët e jashtëm kanë pasur në ambicien e Kosovës për arritjen e pavarësisë.

## **Pyetjet kërkimore**

Pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë:

- Sa ka ndikuar politika ndërkombëtare në jetësimin e planit për shpalljen e Kosovës shtet?
- Cila ka qenë strategjia e politikës kosovare për të fituar mbështetjen ndërkombëtare për pavarësi??
- Sa kanë ndikuar standartet e vendosura ndërkombëtare në vonesën e pavarësisë së Kosovës?

## **Hipotezat e hulumtimit**

Hipotezat e këtij hulumtimi janë:

**H1:** Rasti i Kosovës dhe pavarësimi i saj është ushtrim i parimit të vetëvendosjes së popujve deri në shkëputje (universal).

**H2:** Rruga deri tek realizimi i pavarësisë së Kosovës konsiderohet, si rast suis generis.

## **1.2 Organizimi i temës**

Ky hulumtim përbëhet nga pesë kapituj:

Kapitulli i parë: Hyrje e përgjithshme në lidhje me temën e cila do të trajtohet.

Kapitulli i dytë: Shqyrtim i detajuar i literaturës në lidhje me temën e cila do të trajtohet.

Kapitulli i tretë: Metodologjia dhe materiali i përdorur për grumbullimin e të dhënave.

Kapitullin i katërt: Prezantimi i të gjeturave të hulumtimit.

Kapitulli i pestë: Lidhet me përfundimet dhe rekomandimet e dhëna në lidhje me temën që kam trajtuar.

### 1.3 Rëndësia e temës

Kosova u bë anëtare e Federatës Jugosllave në shekullin e 20-të, e cila përbëhej nga dy krahina dhe gjashtë republika. Dy krahinat e Kosovës dhe Vojvodinës ishin ndër republikat përbërëse, të cilat ishin Republika e Serbisë dhe Malit të Zi, Republika e Maqedonisë, Republika e Sllovenisë, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika e Kroacisë. Themeli i qeverisjes së kësaj federate ishte ideologjia politike e komunizmit. Në këtë rajon - në Evropën Jugore, ku ndodhej Federata Jugosllave - një ndryshim dramatik në histori filloi rreth fundit të shekullit të 20-të.

Të gjitha republikat e tjera ishin shumë më të përgatitura për këtë lloj skenari sesa Kosova, jo vetëm në aspektin e burimeve njerëzore por edhe në aspektin e kapaciteteve ushtarake dhe ekonomike. Natyrisht, kosovarët, të cilët janë në inferioritet total ndaj Serbisë, i ndjekin qëllimet e tyre paqësore – ndarjen nga Serbia dhe shpalljen e Republikës – me mjete paqësore.

Në sfondin e viteve 1980, Serbia kishte shtypur më parë autonominë e Kosovës (1989) dhe të Vojvodinës (1988), të cilat deri në atë moment ishin provincat e saj autonome dhe kështu kishin inicuar jostabilitetin ballkanik. Vija e fundit e mbrojtjes së Kosovës kundër Serbisë ishte ratifikimi nga Kuvendi i Kushtetutës së vendit më 2 korrik 1990, kur delegatët e shpallën Kosovën Republikë dhe paraqitën prova se ajo de jure ishte e ndarë nga Serbia. Kjo fazë u vonua pasi që Kosova nuk ishte në gjendje ta zbatonte këtë vendim të Kuvendit të Kosovës si de jure ashtu edhe de facto (Rrecaj, 2019).

Me kërkesë të Serbisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e OKB-së shqyrtoi dhe mori një vendim për legjitimitetin e shpalljeve të pavarësisë së Kosovës në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës, me qëllim delegitimimin e Kosovës. vlefshmërinë e deklaratës së identifikimit, e cila mbështetet fort nga e drejta ndërkombëtare (<https://www.gazetatema.net/2019/08/16/kosova-me-integritet-territorial-apo-me-territore-te-shkembyera>).

Që nga shpërbërja e hapësirës së ish-Jugosllavisë, Kosova ka paraqitur një çështje vendimtare për të cilën, për mendimin tim, aktualisht nuk ka një zgjidhje përfundimtare që do të siguronte paqen rajonale (Hajrullahu, 2015).

Kjo temë ka një rëndësi jetike sepse paraqet një kaluar të dhimbshme për Kosovën në përpjekjet e saj për të shpallur pavarësinë ndaj Serbisë të cilën e arriti me 17 shkurt 2008.

## Referencat

- Abazi, E. (2012). Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare (1991-1999): Një rast i parashikueshëm. 187-215.
- Aliu, Y., Terziu, L., & Brestovci, A. (2022). Covid-19 and Labour Market in Kosovo. *Икономически изследвания*, 4, 77–92. <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=1040749>
- Bajrami, A. (2018, Maj). Konstitucionalizimi Kosovar pas Shpalljes së Pavarësisë dhe Sfidat e Ndërtimit të tij. 13-14.
- Bajrami, I., & Bajrami, T. (2024). The role and importance of civil initiatives in local governance. *Journal of Governance and Regulation*, 13(2), 126. <https://virtusinterpress.org/The-role-and-importance-of-civil-initiatives-in-local-governance.html>
- Belegu, M., & Rrahmani, B. (2023). Endless EU Facilitated - Mediated Dialogue Between Kosovo and Serbia. Insight Turkey, insightturkey.com. <https://www.insightturkey.com/bashkim-rrahmani/endless-eu-facilitated-mediated-dialogue-between-kosovo-and-serbia>
- Belegu, M., & Rrahmani, B. (2023). Marital and Inheritance Law from the Middle Ages to the Positive Law. From Scanderbeg Canon to Positive Law. *Journal on European History of Law*, 14(1), 202–211. <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=1134138>
- Borovci, M. (2022). Enforceability of International Rule of Law Benchmarks in Legislative Process: The Abrogation of Secondary Legislation in Kosovo. *The Law and Development Review*, 16(1), 23–41. <https://doi.org/10.1515/ldr-2022-0010>
- Buja, V., Qerimi, F., & Behluli, A. (2022). The impact of leadership styles on service quality and customer satisfaction: A comparative analysis between foreign and domestic capital banks in Kosovo. *Innovative Marketing*, 18(3), 181–196. [https://doi.org/10.21511/im.18\(3\).2022.16](https://doi.org/10.21511/im.18(3).2022.16)
- BE & Komisioni Ndërkombëtar për persona të zhdukur. (2017). Personat e zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe pasoja e tij: Vlerësimi i gjendjes 2017. 7-40.
- Dërmaku, V. (2010). Zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ndikimi i saj nga Pakoja e Ahtisaar-it . 3-35.
- Fazliu, L. (2016, Shtator). Paanësia e GJND-së dhe Interpretimi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës. 5-27.
- Fazliu, S. (2017, Shtator). Pavarësia e Kosovës Rast Sui Generis, Apo ushtrim i të drejtës së popujve për vetëvetndosje. 1-28.
- Gruda, P., & Mentor Borovci. (2024). The Constitutional Relevance of the ECHR in Domestic Law: The Kosovo Perspective. *The Law and Development Review*, 17(1), 233–261. <https://doi.org/10.1515/ldr-2023-0110>
- Hajrullahu, A. (2015). Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE. 5-309.
- Hajdari, A. (2022). Proceset Historike dhe Politike deri tek Shpallja e Pavarësisë së Kosovës 1999-2008.

- Halili, N. (2013). Roli i diplomacisë shqiptare në zgjidhjen e krizës së Kosovës gjatë 2004-ës. *Akademia Diplomatike Shqiptare*, 40-47.
- <https://abcnews.al/hapat-diplomatike-qe-ndertuan-historine-e-shtetit-te-kosoves/>. (a.d.).
- <https://besnikpula.wordpress.com/2007/05/25/pse-kosova-duhet-te-jete-precedent/>. (2007, Maj). Pse Kosova duhet të jete precedent. Prishtinë.
- <https://www.gazetatema.net/2019/08/16/kosova-me-integritet-territorial-apo-me-territore-te-shkembyera>. (a.d.). Kosova, me integritet territorial apo me terriore të shkëmbyera. Prishtinë .
- Ibraimi, X., Ziberi, B., & Brestovci, A. (2023). The importance of the regulation of public enterprises. *Corporate Law and Governance Review*, 5(1), 122–128. <https://doi.org/10.22495/clgrv5i1p11>
- Ibraimi, Xh. (2022). Privatization in post-war Kosovo: Legal review. *Journal of Governance and Regulation*, 11(1), 112. <https://virtusinterpress.org/Privatization-in-post-war-Kosovo-Legal-review.html>
- Instituti Demokratik i Kosovës & Konrad Adanuer Stiftung. (2020, Korrik). Kosova: Mes mosnjohjes universale dhe ‘çnjohjeve’. 4-23.
- Instituti i historisë ”Ali Hadri” Prishtinë. (2020). “Kosova - rruga drejt lirisë”. 4-440.
- Instituti Kosovar për Kërkime dhe zhvillime të politikave. (2005, Qershor). Raporti Kosovar: Konflikti, Reagimi Ndërkombëtar, Leksionet e mësuara. 1-336.
- Instituti për Politikë të Jashtme i Kosovës. (2020). Politika e Jashtme e Kosovës nga Këndëvështrimi Shkencor. 9-165.
- Jens Schmitt, O. (2012). Kosova: Histori e Shkurtër e një Treve Qendrore Ballkanike. 1-23.
- Kolenović, L. (2010, Qershor). Diplomacia multilaterale dhe çështja e Kosovës. 1-43.
- Kryeziu, M. (2011, Tetor). Misionet Diplomatike dhe Kosova: Diplomacia, Shërbimet Diplomatike dhe Konsullore. 3-31.
- Kristaj, N. (2018, Tetor). Ndërtimi i Sovranitetit të Kosovës në Tranzicion. 1-30.
- Kiçmari, S. (2020). Reflektimi i zhvillimeve ndërkombëtare në realizimin e interesave nacionale të Republikës së Kosovës. 42-50.
- Lipušček, U. (2008). Parimi i sovranitetit shtetëror dhe e drejta për vetëvendosje: Çështja e Kosovës. 48-60.
- Nurboja, R. (2018, Shkurt ). Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare 1990-2010. 1-163.
- Gashi, R. (2010, Tetor). Shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe Republika e Kosovës. 1-35.
- Jashari, R. (a.d.). Roli i Politikës dhe Diplomacisë për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës (Aspekte nga Rezistenca pasive dhe Lufta për Lirinë e Kosovës).
- Peqani, A. (2011). Kosova dhe Bashkimi European. 1-48.
- Ramadani, I. (2019, Nëntor). Kosova në vitet 89-90. 1-21.
- Rrecaj, M. (2019, Maj). Roli i BE-së në shtet-ndërtimin e Kosovës. 1-37.

- Rrecaj, M. (2019, Prishtinë). Roli i BE-së në Shtet-Ndërtimin e Kosovës. 1-37.
- Rrecaj, M. (2019, Maj). Roli i BE-së në shtet-ndërtimin e Kosovës. 1-37.
- Rrahmani, B., Bushi, P., & Gashi, F. (2023). KOSOVO-SERBIA DIALOGUE: FROM BRUSSELS TO OHRID. *Journal of Liberty and International Affairs*, 9(3), 476–515. <https://doi.org/10.47305/jlia2393476r>
- Rrahmani, B., & Belegu, M. (2022). THE EU ENGAGEMENT IN THE KOSOVO-SERBIA DIALOGUE. *Online Journal Modelling the New Europe*, 39, 127–149. <https://www.cceol.com/search/article-detail?id=1067168>
- Rrahmani, B. (2021). Judicial review and political (in)stability in Kosovo. *Eastern Journal of European Studies*, 12(2), 169–189. <https://www.cceol.com/search/article-detail?id=1019723>
- Rrahmani, B. (2023). BOOK REVIEW: Nick Miller, *The Nonconformists. Culture, Politics, and Nationalism in a Serbian Intellectual Circle, 1944–1991*. *Eastern Journal of European Studies*, 14(2), 265–268. <https://doi.org/10.47743/ejes-2023-0212>
- Pajo, M., & Donik Sallova. (2023). Legal Framework Of The Identity Policy Of The International Community In Post-war Kosovo – A Historical Overview. *Issue 4/2023*, 8(0). <https://ajee-journal.com/legal-framework-of-the-identity-policy-of-the-international-community-in-postwar-kosovo-a-historical-overview#footnote-064>
- Tërmkoll, M. (2023). Exploring the foundations of the European administrative space and its alignment with global governance through the basic principles of good governance. *Corporate Law & Governance Review*, 5(2, special issue), 237. <https://virtusinterpress.org/Exploring-the-foundations-of-the-European-administrative-space-and-its-alignment-with-global-governance-through-the-basic-principles-of-good-governance.html>
- Selimi, G., Xhemazie Ibraimi, & Besime Ziberi. (2022). Law in the tax legal system, income inequality and economic growth: An empirical estimation. *Corporate Governance and Organizational Behavior Review*, 6(2, special issue), 230. <https://virtusinterpress.org/Law-in-the-tax-legal-system-income-inequality-and-economic-growth-An-empirical-estimation.html>
- Sela Kastrati, F. (2014). Bashkimi Europian dhe Kosova.
- Tarifa, F. (2014, January). Pavarësia e Kosovës dhe fundi i Historisë Ballkanike. 27-32.
- Terziu, L., & Belegu, B. (2023). UNDERSTANDING VOTER BEHAVIOR AND ELECTION DYNAMICS: A CASE STUDY OF THE 2021 LOCAL ELECTIONS IN KOSOVO. *Journal of Liberty and International Affairs, Institute for Research and European Studies - Bitola*, 9(2), 450–475. <https://doi.org/10.47305/jlia2392450t>
- Terziu, L., & Buleshkaj, O. (2023). Challenges in Leading Educational Change: Reflections from Educators in Kosovo. *The International Journal of Educational Organization and Leadership*, 30(2), 1–18. <https://doi.org/10.18848/2329-1656/cgp/v30i02/1-18>

- Tasholli, V. (2016, Tetor). Formimi i Shetit të Kosovës dhe Konstituimi i sajë. 1-48.
- Weber, B. & Bajrami, A. (2018, Korrik). Rruga e Kosovës drejtë antarësimit në BE dhe OKB. 1-21.
- Zeka, A. (2020, Mars). Roli i Diplomacisë së Kosovës në Njohjen ndërkombëtare të saj. 1-25.
- Zeqiri, F. (2021, Prill). Kosova dhe Politikat e Ibrahim Rugoves. 1-32.
- Ziberi, B. F., Rexha, D., Ibraimi, X., & Avdiaj, B. (2022). Empirical Analysis of the Impact of Education on Economic Growth. *Economies*, 10(4), 89. <https://doi.org/10.3390/economies10040089>
- Zijadin Gashi. (2008). Rruga e Pavarësisë.